PSH.nr.937/20
986/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenkovic – Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë dhe grupi i OE "H&B Consulting"SH.P.K,-Drzaven Univerzitet Goce Delcev, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ,ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE: "Ambiente S.P.A, Tecnologie Industriali & Ambientali S.P.A: Geosource Consulting SH.P.K : N.SH "Agrovet" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi i materialeve dhe i mbajtjeve që përmbajnë Azbest" , me nr. të prok: KEK-20-3892-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A , më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe i mbajtjeve që përmbajnë Azbest", me nr. të prok: KEK-20-3892-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A.

II. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik "H&B Consulting" SH.P.K,-Drzaven Univerzitet Goce Delcev, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe i mbajtjeve që përmbajnë Azbest" , me nr. të prok: KEK-20-3892-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A.

III. <u>ANULOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull "Trajtimi i materialeve dhe i mbajtjeve që përmbajnë Azbest", me nr. të prok: KEK-20-3892-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A, dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë aprovohet si e azuar, si dhe ankesa e grupit të OE "H&B Consulting"SH.P.K,-Drzaven Univerzitet Goce Delcev, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë dhe grupi i OE:"H&B Consulting" SH.P.K,-Drzaven Univerzitet Goce Delcev, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 12.11.2020 me nr. 937/20, dhe me 20.11.2020 me nr. 986/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi i materialeve dhe i mbajtjeve që përmbajnë Azbest" , me nr. të prok: KEK-20-3892-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7, 13, 59 dhe 59.4 të LPP-së, si dhe nenin 40.13 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 937/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 59.4 të LPP-së dhe 39.8 të RRUOPP-së te ankesa me nr. 986/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 23.11.2020, ka autorizuar ekspertin-teknik shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues-teknik i prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-

ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë,

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimore ka te beje me : Ne baze te përgjigjes nga AK sa i përket pikës tek Certifikata e kualiteti: Kërkesa ne dosjen e tenderi shihet qarte se kërkohen 4 Certifikata ISO te cilat ISO 9001 2015 (ESHTE CERTIFIKAT E KUALITETI) ISO 4001 2015 (ESHTE CERTIFIKAT E SISTEMI TE PERMISIMIT DHE MBROJTJESTE MjEDISIT JETSOR) ISO 45001 2015 (ESHTE CERTIFIKAT MENAXHIMI I MBROJTJES SHENDETSORE NEVENDIN E PUNES) ISO 17025 2017 (ESHTE CERTIFIKAT E KOMPETENCES TE LABARATOREVE PERMATJE ANALIZA DHE KALIBRIM TE SPECIFIKUA NGA FUSHAT PERKATESE, TE CILEN E LESHON AUTORITETI SHETROR ME AUTORIZIM TE ISO (ORGANIZATA NDERKOMBTARE PER AKREDITIM) Pretendimi nga AK-se se Certifikata ISO 17025 është valide për pune me azbest duke mos potencuar kompetencën e laboratorit përmbajtjen dhe testimi e prezencës se azbesti ne materialet, është ne kundërshtim te theksuar me përgjigjen e dhënë nga AK ne letrën sqarues te datës 27.08.2020; Ku po e citojmë: Përgjigje/Ansëer: 8. Analiza e mostrave duhet te jene te tipit PCM (mikroskopi faze -kontrast), metodës NIOSH 7400;Ku anëtari i konzerciumit NSH AGROVET nuk është i akredituar për analiza e azbesti me çka shume qarte dëshmohet nga aneksi i Certifikatës ISO 17025 te lëshuar nga DREJTORIAE PERGJITHESHME E AKREDITIMIT E KOSOVES https://dak.rks-gov.net/desk/inc/media/DDC101C6-4BB6-4F83-AE9A-8B723AC71ADE.pdf Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e autoriteti kontraktues në dosjes të tenderit, Neni 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Dëshmia e kërkuar dokumentare. 1. Certifikatat - Certifimikimi sipas EN- ISO 9001, - Certifimikimi sipas EN- ISO 14001,

- Certifimikimi sipas BS ISO 45001, - Certifimikimi sipas ISO IEC -17025. Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontrate ne ofertën tij ka ofruar certifikatën ISO 17025-2007 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës, Përshkrimi i fushës së akreditimit i kësaj certifikatës është: Testimi për materialet agrogjeologjive, agroekologjike, teknologjike, ushqim dhe ujë, nga kjo shihet se certifikata e ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk trajton analizën për Azbes dhe materialet e tjera me përmbajtje të azbesit, pasi dhe natyra e këtij aktiviteti të prokurimit ka të bëje me "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë asbest". Po ashtu në pyetje/përgjigje autoritet kontraktues sqaron se : Analiza e mostrave duhet të jene të tipit PCM mikroskopi faze-kontrast), metodës NIOSH 7400, operatori ekonomik i rekomanduar për kontrate certifikatën (ISO17025:2007) të çilen e ka ofruar nuk është e specifikuar Metoda e analizave NIOSH 7400. Prandaj , operator ekonomik duhet të pajiset me certifikate e

cila i trajton vendndodhjen dhe llojin e materialeve që përmbajnë asbest(ISO 17025:2017), andaj pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Pretendimi ankimore ka te beje me : Kontratat e punës te ofruara nga Grupi i OP nuk përmbushin kërkesën e AK për tri Referenca te Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në 3 vitet e fundit, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikate për pranimin e furnizimit apo reference nga shfrytëzuesi i fundit. Si shkelje mund te konsiderohet dhe shkaku se këto kontrata janë ofruar vetëm ne gjuhe ITALIANE, e qe është ne kundërshtim me Neni 13 te LPP: Përdorimi gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik; Eksperti shqyrtues sqaron se kërkese e autoriteti kontraktues në dosje të tenderit Neni 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 2. Referencë për shërbimet e kërkuara - Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Tri referenca Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën, dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikate për pranimin e mallit apo referencë nga shfrytëzuesi i fundit. Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar referenca, Proof 1, Proof 2, Proof 3, Proof 6, Proof 7, Proof 8, të gjitha këto në gjuhën Italiane, mirëpo sipas LLP-së Neni 13 pika .4 Operatori ekonomik mund të dërgojë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje ose një dokument tjetër që duhet ose lejohet që të arkivohet gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze, ndërsa Proof 4 dhe Proof 5(Reference) në gjuhën Angleze, mirëpo grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ju ka përmbajtur kërkesa të kërkuar në dosje të tenderit. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Pretendimi ankimor ka të bëjë me: Përgjigja nuk qëndron nga AK për arsye se OE nuk kane ofruar stafet e licencuar për azbes të dhe nuk kanë ofruar asnjë dëshmi për Ekspert te licencuar OE ka ofruar certifikatat e trajnimeve por jo licence te eksperteve, te cilat nuk i përmbushin kërkesat e AK.

Eksperti shqyrtues sqaron se kërkese e autoriteti kontraktues është : Dy (2) ekspertë të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbestit. Eksperti i pare duhet të jetë ekspert i lemisë sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU dhe të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në termocentrale, me referenca në azbest, lesh mineral dhe substance të rrezikshme. Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tije nuk ka ofruar Ekspert të Licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbesit. Eksperti i pare z.D.Cattaneo është i certifikuar për të vepruar gjatë punës në lidhje me rreziqet e asbesit, por nuk është i licencuar. Eksperti dyte z. G Pandoro është i certifikuar

për të vepruar gjatë punës në lidhje me rreziqet e asbesit, por nuk është i licencuar. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Pretendimi ankimore ka të bej me: Pikat 3.1, 3.2, 3.3 Grupi O.E. të shpallur fitues ka prezantuar në oferte te gjithë dokumentacionin ne lidhje me Një (1) inxhinier i makinerisë me se paku tre vjet përvojë pune , Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune si dhe në Propozimin teknik ka ofruar një ekspert mbështetës në zyrë (shif. Propozimin teknik në ofertë). Përgjigja për pike 3.1,3.2,3.3 është e pa sakte, pasi që në dokumente e OE nuk ka prezantuar: 3.1 Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre vjet përvojë pune 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune 3.3 Një ekspert mbështetës në zyrë. Ekspert shqyrtues sqaron se Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tije ka ofruar CV për 3.1 Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre vjet përvojë pune, 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune, komisioni gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar informacion shtese lidhur me Diplomat e inxhinierëve te prezantuar ne ofertën e tije, dhe me datë 16.10.2020 grupi i operatoreve ekonomik te rekomanduar për kontratë ka prezantuar diplomat për të dy inxhinieret, ndërsa për 3.3 Një ekspert mbështetës në zyrë nuk ka ofruar as një CV apo ndonjë dokument lidhur me ekspertin mbështetës në zyrë,por vetëm një përshkrim për veprimtarin e tij(në dokumentin: Technical Proposal), të kërkuar në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pjesërisht i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 5

Pretendimi ankimor ka të bej me :Grupi OP nuk ka prezantua kompani te licencuar ashtu si kërkohet ne Dosje të tenderit. Sipas pyetjes sqaruese nga një OE, AK – KEK ofron këtë përgjigje ne numrin rendor 12: .Për hartimin e raportit VMNS sipas rregullativës ligjore ne fuqi, kompania hartuese duhet te jete e licencuar nga Ministria. Eksperti shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në Përgjigje/Ansëer: 12. Për hartimin e raportit të VMNS sipas rregullativës ligjore në fuqi, kompania hartuese duhet të jetë e licencuar nga Ministria, kjo dilemë është ngritur gjatë sqarimeve shtesë nga autoriteti kontraktues, ku komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të ofertave kërkon nga Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë informacione shtesë me datë 15.10.2020, ndërsa me janë përgjigjur me 16.10.2020, sqaron se anëtari i grupi të OE-ve Geosource Consulting Sh.p.k është e licencuar me "Licencë" dhe duke dërguar dokumentin autoriteti kontraktues pasi ky dokument nuk ka qenë i ngarkuar ne dosjen e tenderit të grupit të OE-ve, andaj pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 6

Pretendimi ankimore ka të bej me: Grupi i OP nuk ka ofruar Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës prej 120 dite ashtu si kërkohet ne Dosje tenderike, te Neni 5.2 – Udhëzimet për Tenderuesit, Grupi i OP nuk ka ofruar Deklaratën mbi specifikimet teknike të detyrueshme, ashtu si kërkohet ne Dosje tenderike te ANEKS 1. Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tije ka ofruar Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës prej 120 dite, në file –KEK Asbestos Technical Proposal rev 29.09- "Implementation period for this project is 120 days.", ndërsa Deklarata mbi specifikimin teknik të detyrueshme nuk ka qenë pjesë e dosjes se tenderit. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 7

Pretendimi ankimore ka të bej me: Certifikata e ofruar nga Grupi OE nuk ka te beje me ne asnjë aspekt me lëmin e azbestit. Sipas pyetjes sqaruese nga një OE, AK - KEK ofron këtë përgjigje ne numrin rendor 8: Analiza e mostrave duhet te jene te tipit PCM (mikroskopi faze -kontrast), metodës NIOSH 7400; Certifikata e ofruar nuk është ne përputhje me dëshminë e ofruar si dhe me sqarimin e dhënë, pasi nuk përmban fare aneks certifikatë ISO 17025/2007, gjë qe mund te vërtetohet:DREJTORIA E PERGJITHESHME E AKREDITIMIT E KOSOVES(https://dak.rks-gov.net/desk/inc/media/DDC101C6-4BB6- *4F83-AE9A-8B723AC71ADE.pdf}',* Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE-ve " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e autoriteti kontraktues në dosjes të tenderit, Neni 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Dëshmia e kërkuar dokumentare. 1. Certifikatat - Certifimikimi sipas EN- ISO 9001, - Certifimikimi sipas EN- ISO 14001, - Certifimikimi sipas BS ISO 45001, - Certifimikimi sipas ISO IEC -17025.

Grupi i Operatorëve ekonomik " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" ne ofertën tij ka ofruar certifikatën MRC EN ISO/IEC 17025:2006 Annex to this Cerfficate murked ëith the sume number Accreditation CertiJicate No, LT 052 (MKS EN ISO/IEC 17025:2018). të lëshuar nga "Institute for Accreditation of the Republic of North Macedonian", Përshkrimi i fushës së akreditimit i kësaj certifikatës është: Laboratory for control of qualitative and quantitative parameters of ambient air in real condition and real time, determining the level of personal exposure to certain hazards and an examination of morfology and chemical composition of various materials, nga kjo shihet se certifikata e ofruar nga Grupi i OE-ve " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" nuk trajton analizën për azbes dhe materialet e tjera me përmbajtje të azbesit, pasi dhe natyra e këtij aktiviteti të prokurimit ka të bëje me "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë asbest". Po ashtu në pyetje/përgjigje autoritet kontraktues sqaron se : Analiza e mostrave duhet të jene të tipit PCM (mikroskopi faze-kontrast), metodës NIOSH 7400, grupi i operatorëve ekonomik, certifikatën (ISO17025:2006) të cilën e ka ofruar nuk është e specifikuar

Metoda e analizave NIOSH 7400. Prandaj , operator ekonomik duhet të pajiset me certifikate e cila i trajton vendndodhjen dhe llojin e materialeve që përmbajnë asbest(ISO 17025:2017), andaj pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 8

Pretendimi ankimor ka të bej me: Grupi i OP nuk ka ofruar vetëm një (1) kontrate te punës, qe do te thotë se nuk përmbushin kërkesën e AK për tri Referenca te Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në 3 vitet e fundit, duke saktësua produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikatë për pranimin e furnizimit apo reference nga shfrytëzuesi i fundit. Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i Operatorëve ekonomik " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" në fortën e tij nuk ka ofruar,Tri Referenca te Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në 3 vitet e fundit, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikate për pranimin e furnizimit apo referencë nga shfrytëzuesi i fundit, *t*ë kërkuara në dosjen e tenderit. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr. 9

Pretendimi ankimor ka të bej me: Grupi i OP nuk ka ofruar Ekspertet e licencuar për materialet me përmbajtjeje e asbestit, por ka prezantua ne ofertë vetëm Certifikata te trajnimeve te ndryshme por jo licenca, prandaj komisioni vlerësues ka vepruar ne kundërshtim me LPP, me rastin e pranimit te referencave ne vend te Licencave. Eksperti i pare se paku 5 vite provoje pune ne trajtimin e mbetjeve ne termocentrale me referenca ne azbest lesh mineral dhe substance te rrezikshme. Sipas pyetjes sqaruese nga një OE, AK - KEK ofron këtë përgjigje ne numrin rendor 16. Ne kemi kërkuar mes tjerash: Dy (2) ekspertë të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbestit. Eksperti I pare duhet të jetë eksperti lamisë sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU dhe të ketë së paku 5 [pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në termocentrale, me referenca në azbest, lesh mineral dhe substance të rrezikshme; Mirëpo janë te pranueshme edhe referencat qe dëshmoj në përvojën ne objektet industriale.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "H&b Consulting" SH.P.K,-:Drzaven Univerzitet Goce Delcev,

Eksperti shqyrtues sqaron se Grupi i Operatorëve ekonomik " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" në ofertën e tij nuk ka ofruar ekspertë të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbestit, por në ofertën e tij ka ofruar vetëm Certifikata të trajnimeve të ndryshme të cilat

nuk kanë të bëjnë me Trajtimin e materialeve dhe mbetjeve qe përmbajnë Azbest. Andaj, pretendimi ankimor i operatorin ekonomik ankues është i bazua.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

OE "H&B CONSULTING Sh.p.k - DRZAVEN UNIVERZITET GOCE DELCEV" Pretendimi ankimore ka të bej me : CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të më tejshëm 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Pika 3. Stafi i kompanisë, dëshmitë për: 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune 3.3 Një ekspert mbështetës në zyrë Provë 3.2 OE ka prezantuar CV-në e z. BOSHNJAKU KRESHNIK i cili nuk është inxhinier i elektrikes pasi që sipas CV-së së prezantuar është me gradë Bachelor dhe nuk e plotëson këtë kusht të kërkuar në dosje të tenderit dhe Masterin nuk e ka përfunduar andaj AK është dashur të eliminoj sipas RRUOPP Neni 39.8 pa kërkuar informacione shtesë pasi që CV nuk i plotëson kushtet/kriteret sipas dosjes së tenderit. 3. Po ashtu OE nuk ka plotësuar kriterin sipas dosjes 3.3 - Një ekspert mbështetës në zyrë.

Expert Name	Country	CV	Proof
Cattaneo Davide	Italy	Pag. 3To 8	Pag. 9 to 16
Pandcro Giuseppe	Italy	Pag 17	Pag. 18 to 22
Arben Avdiu	Kosovo	Pag. 23 to 25	
BOSHNJAKU	Kosovo	Pag 26 to 32	

Provë 3.3 Mungon eksperti mbështetës. Nuk është prezantuar dhe nuk është specifikuar .

AK ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhenë përgjigje lidhur me CV (piken e cila nuk e plotëson kërkesën ne dosjen e tenderit duke shmangur përgjigjën për këtë cilën ne te cilën e kemi kontestua. Ekspert shqyrtues sqaron se Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tije ka ofruar CV për 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune, komisioni gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar informacion shtese lidhur me Diplomën e inxhinierit te prezantuar ne ofertën e tije, dhe me datë 16.10.2020 grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për kontratë ka prezantuar diplomën e inxhinierit, ndërsa titulli Master nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tije për, **3.3** Një ekspert mbështetës në zyrë nuk ka ofruar as një CV apo ndonjë dokument lidhur me ekspertin mbështetës në zyrë, por vetëm një përshkrim për veprimtarin e tij(në dokumentin:Technical Proposal) , të kërkuar në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pjesërisht i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues"Ar-Tech" sh.p.k –Prishtinë, është e bazuar,ndërsa ankesa e OE"H&B CONSULTING Sh.p.k -

DRZAVEN UNIVERZITET GOCE DELCEV", pjesërisht e bazuar ,ndërsa të anulohet njoftimi për dhënie për kontratë, dhe këtë aktivitetit të prokurimit të kthej në **rivlerësim.**

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik: "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë, me datë 27.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik: "H&b Consulting" SH.P.K,-:Drzaven Univerzitet Goce Delcev, me datë 30.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në , se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se në bazë të përgjigjes nga AK sa i përket pikës tek Certifikata e kualiteti: Kërkesa në dosjen e tenderi shihet qartë se kërkohen 4 Certifikata ISO të cilat ISO 9001 2015 (është certifikatë e kualitetit) ISO 4001 2015 (është certifikatë e sistemit të përmrësimit dhe mbrojtjes së mjedisit jetësor) ISO 45001 2015 (është certifikatë menaxhimi i mbrojtjes shëndetsore në vendin e punës) ISO 17025 2017 (është certifikatë e kompetencës të labaratoreve për matje analiza dhe kalibrim të specifikuar nga fushat përkatese, të cilen e lëshon autoriteti shetror me autorizim të iso (organizata nderkombtare per akreditim). Pretendimi nga AK se Certifikata ISO 17025 është valide për punë me azbest duke mos potencuar kompetencën e laboratorit përmbajtjen dhe testimin e prezencës së azbesti në materialet është në kundërshtim të theksuar me përgjigjen e dhënë nga AK në letrën sqaruese të datës 27.08.2020.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues në dosje të tenderit, Neni 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Dëshmia e kërkuar dokumentare. 1. Certifikatat - Certifimikimi sipas EN- ISO 9001, - Certifimikimi sipas EN- ISO 14001, - Certifimikimi sipas BS ISO 45001, - Certifimikimi sipas ISO IEC -17025.
Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën tij ka ofruar certifikatën ISO 17025-2007 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës, Përshkrimi i fushës së akreditimit i

kësaj certifikatës është: Testimi për materialet agrogjeologjive, agroekologjike, teknologjike, ushqim dhe ujë, nga kjo shihet se certifikata e ofruar nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk trajton analizën për Azbes dhe materialet e tjera me përmbajtje të azbesit, pasi dhe natyra e këtij aktiviteti të prokurimit ka të bëjë me "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë asbest". Po ashtu në pyetje/përgjigje autoritet kontraktues sqaron se: Analiza e mostrave duhet të jene të tipit PCM mikroskopi faze-kontrast), metodës NIOSH 7400, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë certifikatën (ISO17025:2007) të cilën e ka ofruar nuk është e specifikuar Metoda e analizave NIOSH 7400. Prandaj, operatori ekonomik duhet të pajiset me certifikate e cila i trajton vendndodhjen dhe llojin e materialeve që përmbajnë asbest(ISO 17025:2017). Pra, pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëjë me: Kontratat e punës të ofruara nga Grupi i OE nuk përmbushin kërkesën e AK për tri Referenca te Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në 3 vitet e fundit, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikate për pranimin e furnizimit apo reference nga shfrytëzuesi i fundit. Si shkelje mund te konsiderohet dhe shkaku se këto kontrata janë ofruar vetëm ne gjuhe ITALIANE, e qe është ne kundërshtim me Neni 13 te LPP: Përdorimi gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik;

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e autoritetit kontraktues në dosje të tenderit Neni 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 2. Referencë për shërbimet e kërkuara - Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Tri referenca Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën, dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur së paku një certifikatë për pranimin e mallit apo referencë nga shfrytëzuesi i fundit. Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar referenca, Proof 1, Proof 2, Proof 3, Proof 6, Proof 7, Proof 8, të gjitha këto në gjuhën Italiane, mirëpo sipas LLP-së Neni 13 pika .4 Operatori ekonomik mund të dërgojë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje ose një dokument tjetër që duhet ose lejohet që të arkivohet gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze, ndërsa Proof 4 dhe Proof 5(Reference) në gjuhën Angleze. Por grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ju ka përmbajtur kërkesa të kërkuar në dosje të tenderit. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor i radhës nga OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëjë me: Përgjigja nuk qëndron nga AK për arsye se OE nuk kane ofruar stafet e licencuar për azbes të dhe nuk kanë ofruar asnjë

dëshmi për Ekspert te licencuar OE ka ofruar certifikatat e trajnimeve por jo licence te eksperteve, te cilat nuk i përmbushin kërkesat e AK.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e autoriteti kontraktues është: Dy (2) ekspertë të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje të asbestit. Eksperti i pare duhet të jetë ekspert i lëmisë sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU dhe të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në termocentrale, me referenca në azbest, lesh mineral dhe substance të rrezikshme. Grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij nuk ka ofruar ekspert të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbesit. Eksperti i pare z.D.Cattaneo është i certifikuar për të vepruar gjatë punës në lidhje me rreziqet e asbesit, por nuk është i licencuar. Eksperti dyte z. G Pandoro është i certifikuar për të vepruar gjatë punës në lidhje me rreziqet e asbesit, por nuk është i licencuar. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi tjetër i OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëjë me: Pikat 3.1, 3.2, 3.3 Grupi O.E. të shpallur fitues ka prezantuar në ofertë të gjithë dokumentacionin ne lidhje me Një (1) inxhinier i makinerisë me se paku tre vjet përvojë pune , Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune si dhe në Propozimin teknik ka ofruar një ekspert mbështetës në zyrë (shif. Propozimin teknik në ofertë). Përgjigja për pike 3.1,3.2,3.3 është e pa sakte, pasi që në dokumente e OE nuk ka prezantuar: 3.1 Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre vjet përvojë pune 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune 3.3 Një ekspert mbështetës në zyrë. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tije ka ofruar CV për 3.1 Një (1) inxhinier i makinerisë me së paku tre vjet përvojë pune, 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune, komisioni gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar informacion shtese lidhur me Diplomat e inxhinierëve te prezantuar ne ofertën e tije, dhe me datë 16.10.2020 grupi i operatoreve ekonomik te rekomanduar për kontratë ka prezantuar diplomat për të dy inxhinieret, ndërsa për 3.3 Një ekspert mbështetës në zyrë nuk ka ofruar as një CV apo ndonjë dokument lidhur me ekspertin mbështetës në zyrë, por vetëm një përshkrim për veprimtarin e tij(në dokumentin: Technical Proposal), të kërkuar në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pjesërisht i bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëë me grupi i operatorëve ekonomik nuk ka prezantuar kompani te licencuar ashtu si kërkohet ne Dosje të tenderit. Sipas pyetjes sqaruese nga një OE, AK – KEK ofron këtë përgjigje ne numrin rendor 12: .Për hartimin e raportit VMNS sipas rregullativës ligjore ne fuqi, kompania hartuese duhet te jete e licencuar nga Ministria.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në Përgjigje / Ansëer: 12. Për hartimin e raportit të VMNS sipas rregullativës ligjore në fuqi, kompania hartuese duhet të jetë e licencuar nga Ministria, kjo dilemë është ngritur gjatë sqarimeve shtesë nga autoriteti kontraktues, ku komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të ofertave kërkon nga grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë informacione shtesë me datë 15.10.2020, ndërsa me janë përgjigjur me 16.10.2020, sqaron se anëtari i grupit të OE-ve Geosource Consulting Sh.p.k është e licencuar me "Licencë" dhe duke dërguar dokumentin autoriteti kontraktues pasi ky dokument nuk ka qenë i ngarkuar ne dosjen e tenderit të grupit të OE-ve, andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë që ka të bëjë me: grupi i OE nuk ka ofruar Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës prej 120 dite ashtu si kërkohet ne Dosje tenderike, te Neni 5.2 – Udhëzimet për Tenderuesit, Grupi i OP nuk ka ofruar Deklaratën mbi specifikimet teknike të detyrueshme, ashtu si kërkohet ne Dosje tenderike te ANEKS 1.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë ne ofertën e tij ka ofruar Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës prej 120 dite, në file –KEK Asbestos Technical Proposal rev 29.09- "Implementation period for this project is 120 days.", ndërsa Deklarata mbi specifikimin teknik të detyrueshme nuk ka qenë pjesë e dosjes se tenderit. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëjë me: Certifikata e ofruar nga Grupi OE nuk ka te beje me ne asnjë aspekt me lëmin e azbestit. Sipas pyetjes sqaruese nga një OE, AK - KEK ofron këtë përgjigje ne numrin rendor 8: Analiza e mostrave duhet te jene te tipit PCM (mikroskopi faze - kontrast), metodës NIOSH 7400; Certifikata e ofruar nuk është ne përputhje me dëshminë e ofruar si dhe me sqarimin e dhënë, pasi nuk përmban fare aneks certifikatë ISO 17025/2007, gjë qe mund te vërtetohet:DREJTORIA E PERGJITHESHME E AKREDITIMIT E KOSOVES(https://dak.rks-gov.net/desk/inc/media/DDC101C6-4BB6- *4F83-AE9A-8B723AC71ADE.pdf}',* Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE-ve " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e autoriteti kontraktues në dosjes të tenderit, Neni 9.1 & 9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Dëshmia e kërkuar dokumentare. 1. Certifikatat - Certifimikimi sipas EN- ISO 9001, - Certifimikimi sipas EN- ISO 14001, - Certifimikimi sipas BS ISO 45001, - Certifimikimi sipas ISO IEC -17025.
Grupi i operatorëve ekonomik " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" ne ofertën tij ka ofruar certifikatën MRC EN ISO/IEC 17025:2006 Annex to this Cerfficate murked ëith the

sume number Accreditation CertiJicate No, LT 052 (MKS EN ISO/IEC 17025:2018) të lëshuar nga "Institute for Accreditation of the Republic of North Macedonian". Përshkrimi i fushës së akreditimit i kësaj certifikatës është: Laboratory for control of qualitative and quantitative parameters of ambient air in real condition and real time, determining the level of personal exposure to certain hazards and an examination of morfology and chemical composition of various materials, nga kjo shihet se certifikata e ofruar nga Grupi i OE-ve " H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" nuk trajton analizën për azbes dhe materialet e tjera me përmbajtje të azbesit, pasi dhe natyra e këtij aktiviteti të prokurimit ka të bëje me "Trajtimi i materialeve dhe mbetjeve që përmbajnë asbest". Po ashtu në pyetje/përgjigje autoritet kontraktues sqaron se : Analiza e mostrave duhet të jene të tipit PCM (mikroskopi faze-kontrast), metodës NIOSH 7400, grupi i operatorëve ekonomik, certifikatën (ISO17025:2006) të cilën e ka ofruar nuk është e specifikuar Metoda e analizave NIOSH 7400. Prandaj, operatori ekonomik duhet të pajiset me certifikate e cila i trajton vendndodhjen dhe llojin e materialeve që përmbajnë asbest(ISO 17025:2017), andaj pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi tjetër ankimor i OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëjë me: Grupi i OE nuk ka ofruar vetëm një (1) kontrate te punës, qe do te thotë se nuk përmbushin kërkesën e AK për tri Referenca te Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në 3 vitet e fundit, duke saktësua produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikatë për pranimin e furnizimit apo reference nga shfrytëzuesi i fundit.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik "H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" në ofertën e tij nuk ka ofruar Tri Referenca te Shërbimeve të natyrës së ngjashme, të realizuar në 3 vitet e fundit, duke saktësuar produktet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit, duke ia bashkangjitur se paku një certifikate për pranimin e furnizimit apo referencë nga shfrytëzuesi i fundit, *t*ë kërkuara në dosjen e tenderit. Andaj pretendimi ankimor i operatorit ekonomik ankues është i bazuar.

Pretendimi i radhës së OE ankues "Ar-Tech"SH.P.K-Prishtinë ka të bëjë me: Grupi i OE nuk ka ofruar Ekspertet e licencuar për materialet me përmbajtjeje e asbestit, por ka prezantua ne ofertë vetëm Certifikata te trajnimeve te ndryshme por jo licenca, prandaj komisioni vlerësues ka vepruar ne kundërshtim me LPP, me rastin e pranimit te referencave ne vend te Licencave. Eksperti i pare se paku 5 vite provoje pune ne trajtimin e mbetjeve ne termocentrale me referenca ne azbest lesh mineral dhe substance te rrezikshme. Sipas pyetjes sqaruese nga një OE, AK - KEK ofron këtë përgjigje ne numrin rendor 16. Ne kemi kërkuar mes tjerash: Dy (2) ekspertë të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbestit. Eksperti I pare

duhet të jetë eksperti lamisë sipas normave të EU apo ekuivalent me normat e EU dhe të ketë së paku 5 [pesë) vite përvojë pune në trajtimin e mbetjeve në termocentrale, me referenca në azbest, lesh mineral dhe substance të rrezikshme; Mirëpo janë te pranueshme edhe referencat qe dëshmoj në përvojën ne objektet industriale.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: "H&b Consulting" SH.P.K,-:Drzaven Univerzitet Goce Delcev

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik "H & B - Consulting Sh.P.K.; Drzaven Univerzitet Goce Delcev Stip" në ofertën e tij nuk ka ofruar ekspertë të licencuar për trajtimin e materialeve me përmbajtje te asbestit, por në ofertën e tij ka ofruar vetëm Certifikata të trajnimeve të ndryshme të cilat nuk kanë të bëjnë me Trajtimin e materialeve dhe mbetjeve qe përmbajnë Azbest.

Lidhur me pretendimin e OE "H&B CONSULTING Sh.p.k - Drzaven Univerzitet Goce Delcev"që ka të bëjë me: CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat - Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të më tejshëm 9.1 & 9.2 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Pika 3. Stafi i kompanisë, dëshmitë për: 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune 3.3 Një ekspert mbështetës në zyrë Provë 3.2 OE ka prezantuar CV-në e z. BOSHNJAKU KRESHNIK i cili nuk është inxhinier i elektrikes pasi që sipas CV-së së prezantuar është me gradë Bachelor dhe nuk e plotëson këtë kusht të kërkuar në dosje të tenderit dhe Masterin nuk e ka përfunduar andaj AK është dashur të eliminoj sipas RRUOPP Neni 39.8 pa kërkuar informacione shtesë pasi që CV nuk i plotëson kushtet/kriteret sipas dosjes së tenderit. 3. Po ashtu OE nuk ka plotësuar kriterin sipas dosjes 3.3 - Një ekspert mbështetës në zyrë.

Expert Name	Country	CV	Proof
Cattaneo Davide	Italy	Pag. 3To 8	Pag. 9 to 16
Pandcro Giuseppe	Italy	Pag 17	Pag. 18 to 22
Arben Avdiu	Kosovo	Pag. 23 to 25	
BOSHNJAKU	Kosovo	Pag 26 to 32	

Provë 3.3 Mungon eksperti mbështetës. Nuk është prezantuar dhe nuk është specifikuar .

AK ne përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhenë përgjigje lidhur me CV (piken e cila nuk e plotëson kërkesën ne dosjen e tenderit duke shmangur përgjigjën për këtë cilën ne te cilën e kemi kontestua.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi i operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka ofruar CV për 3.2 Një (1) inxhinier i elektrikes me së paku tre vjet përvojë pune, komisioni gjatë vlerësimit të ofertave ka kërkuar informacion shtese lidhur me Diplomën e inxhinierit te prezantuar ne ofertën e tije, dhe me datë 16.10.2020 grupi i operatoreve ekonomik të rekomanduar për

kontratë ka prezantuar diplomën e inxhinierit, ndërsa titulli Master nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Grupi i Operatorëve ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tije për, **3.3** Një ekspert mbështetës në zyrë nuk ka ofruar as një CV apo ndonjë dokument lidhur me ekspertin mbështetës në zyrë, por vetëm një përshkrim për veprimtarin e tij(në dokumentin:Technical Proposal) , të kërkuar në dosje të tenderit. Andaj, pretendimi ankimore i operatorit ekonomik ankues është i pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues/teknik, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë vlerësimin e tenderëve në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit, si dhe në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të tenderëve të veproj në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe konform kritereve të përcaktuara në dosje të tenderit. Gjithashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që ta kenë paraysh qëllimin e ligjit, ku secili autoritet kontraktues duhet të sigurohet që fodnet publike të shfrytëzohen në mënyrë me ekonomike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Korporata Energjetike e Kosovës"SH.A.;

1x1 OE "AR-Tech"SH.P.K-Prishtinë;

1x1 OE "H&B Consulting "SH.P.K-Drzaven Univerzitet Goce Delcev;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.